

contra - Zyra e specializuar kundër trafikimit të njerëzve në Schleswig-Holstein

Workers_SH

Një projekt kundër punës së detyruar në Schleswig-Holstein

Këshillim dhe Ndihmë

Jeni në një gjëndje të rrezikshme?

Në Gjermani keni të drejtën për mbrojtje dhe ndihmë!

Jeni të prekur nga puna e detyruar?

- A ju janë dhënë premtime të rreme për kushtet e punës (kontrata, koha, vendi, paga)?
- A jeni të detyruar të bëni punë që nuk ishin marrë vesh ose me të cilat nuk jeni dakord?
- A kërkohet prej jush shlyerja e borxheve të pretenduar tek një ndërmjetës ose punëdhënës?
- A keni marrë pak ose fare para për punën tuaj?
- A jeni çuar pa pëlqimin tuaj në një vend pune dhe/ose vëndbanim që ju nuk e njihni?
- A jeni shantazhuar, kërcënuar, rrahur ose të mbikqyrur nga punëdhënësi juaj?

Nëse keni përjetuar diçka të tillë ose të ngjashme – ne nga Workers_SH ju ndihmojmë:

- Me informacione për të drejtat tuaja
- Në kërkimin e një vëndbanimi të sigurtë
- Me sende për kujdes të parë (ushqim, veshmbathje, artikuj higjiene)
- Në ndërmjetësimin e një këshillimin tek mjekët urgjent
- Në komunikimin me autoritetet shtetërore si p.sh. Jobcenter (zyrat e asistencës sociale)

Tek Workers_SH të prekurit e çdo moshe, të çdo gjinie dhe nga çdo vend këshillohen falas, në mënyrë anonime dhe konfidenciale në gjuhën e tyre amtare (me ndihmën e përkthyesve).

Na telefononi ose kërkojini dikujt ta bëjë këtë. Flisni lirisht në gjuhën tuaj – edhe në sekretarinë telefonike. Ne do t'ju kthejmë përgjigjen patjetër!

Workers_SH
0431 55 77 91 94
workers@hb5.nordkirche.de

Asgjë nuk ndodh kundër vullnetit tuaj!

Ndihmë për të prekurit nga trafikimi i personave dhe prostitucioni i detyruar:
contra – Zyra e specializuar kundër trafikimit të njerëzve në Schleswig-Holstein
Kutia postare 35 20
24034 Kiel
0431 55 77 91 91
contra@frauenwerk.nordkirche.de